

VENDIM
Nr. 573, datë 6.12.2017

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 6.12.2017, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Gëzim	Veleshnja	anëtar
Hysen	Osmanaj	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, në Qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas përfundimit të mandatit të deputetit të z. Bujar Muça.

Kërkues: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Baza ligjore: Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 3042/1 prot., datë 1.12.2017, drejtuar KQZ-së, Sekretari Përgjithshëm i Kuvendit, z. Genci Gjonçaj, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Bujar Muça, deputet i zonës zgjedhore, Qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënie e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike, në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 555, datë 26.7.2017, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017, si dhe miratoi listën emërore të deputetëve të zgjedhur për çdo subjekt, për çdo zonë zgjedhore. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet për zonën zgjedhore Qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Qershor 2017, ka fituar 2 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet për Qarkun Elbasan, është si më poshtë: me numër rendor 1 (një) z. Aqif Kahraman Rakipi dhe 2 (dy) z. Bujar Shahin Muça.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në Qarkun Elbasan i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, me kandidatin e radhës. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca nuk i përket një mandati të fituar sipas pikës 6, të nenit 67 të Kodit Zgjedhor, për të zbatuar përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, fjalë e dytë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës së Partisë Drejtësi,

Integrim dhe Unitet në zonën zgjedhore Qarku Elbasan.

KQZ-ja, me vendimin nr. 287, datë 5.5.2017, “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.6.2017”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet për 12 zonat zgjedhore.

Referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, nenit 2 të tij, të dhënat e deklaruara në formularin e vetëdeklarimit dhe informacionit të ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, asnjë kandidat nuk është në kushtet e nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, për refuzimin e tyre si kandidatë për deputet të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet.

Sipas listës shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet për Qarkun Elbasan, kandidati i radhës është kandidati me numër rendor 3 (tre), znj. Elena Josif Xhina.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatit të radhës, i renditur me numër rendor 3 (tre) në listën shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në zonën zgjedhore Qarku Elbasan, znj. Elena Josif Xhina.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Qarku Elbasan, znj. Elena Josif Xhina.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (ditë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

KRYETAR
Klement Zguri